

VENDIM
Nr. 510, datë 27.10.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 420, DATË 29.9.2022, “PËR LICENCAT
DHE TARIFAT E SHËRBIMIT TË OPERATORËVE UK DERI NË PËRFUNDIM
TË PROCEDURAVE TË RIORGANIZIMIT DHE TRANSFERIMIT TË
SHOQËRIVE UK NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA”**

Në zbatim të neneve 14, germat “e” dhe “i”, dhe 19 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, në të cilin edhe ERRU-ja ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni Kombëtar Rregullator, duke pasur në konsideratë periudhën kohore që iu nevojitet njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe shoqërive UK për përfundimin e procedurave të riorganizimit në subjekte me kompetenca të përbashkëta (SKP-UK), si edhe aplikimin për tarifa të reja sipas vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 420, datë 29.9.2022, “Për licencat dhe tarifat e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta” në pikën tre fjalia “... që do të kryhet bazuar në të dhënat e një viti ushtrimor të aktivitetit të shoqërisë SKP.” ndryshohet si vijon: “që do të kryhet bazuar në të dhënat e vitit ushtrimor të aktivitetit të shoqërive UK dhe të shoqërive SKP.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë UK dhe SKP-UK, si dhe të gjitha strukturat e ERRU-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani